



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 08/L - 014**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE PËR IPA 2020  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT  
EVROPIAN”**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE PËR  
IPA 2020 NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT  
EVROPIAN”**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ratifikimi i “Marrëveshjes financiare për IPA 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”.

**Neni 2**  
**Ratifikimi i Marrëveshjes**

“Marrëveshja financiare për IPA 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”, konsiderohet e ratifikuar me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Marrëveshja dhe shtojcat e saj janë pjesë integrale të këtij ligji.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-014**  
**22 korrik 2021**

**Glauk KONJUFCA**

---

**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**